



Pranuar / Dorëzuar Prinjenof/Prodato Received/Delivety	16-01-2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedimica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHEK	403/2023		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1087/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1087/2022 të datës 02.12.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë vendbanimi, Komuna e Klinës, kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.01.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.1087/2022 e datës 02.12.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KD.nr.048/2022 i datës 23.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Ankuesit \_\_\_\_\_ i punësuar në pozitën e Mbikëqyrësit në Qendrën e Paraburgimit në Pejë - Shërbimi Korrektues i Kosovës, me datë 02.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7585/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1087/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.nr.048/2022 të datës 23.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore "Ndalim 20% i pagës për një periudhë prej dy (2) muaj", për shkak të publikimit dhe shpërndarjes së shkresave zyrtare të SHKK-së me datë 03.11.2022 në rrjete sociale (facebook).



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 05.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datë 11.01.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, përmes e-mailit zyrtar, i protokolluar me numër 167/2023.

**Kolegji i Këshillit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritor administroi këto prova:** Ankesë me numër protokolli 7585/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1087/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KDnr.048/2022 të datës 23.11.2022 të Komisionit Disiplinorë në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Inicimin e procedurës disiplinore me numër protokolli 6868/222 të datës 04.11.2022; Ftesën për seancë dëgjimore të datës 14.11.2022; E-mailin e datës 12.09.2022 nga ankuesi për z. me subjekt: Raporti i mb; E-mailin e datës 02.09.2022 nga z. subjekti Raporti i mb; Përgjigjen në ankesë të datës 11.01.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, përmes e-mailit zyrtar, i protokolluar me numër 167/2023; Kontratën e punës për ankuesin të datës 30.06.2018; Fletëkthesën e datës 23.11.2022, pranimit të vendimit; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2021 të datës 11.01.2022, dhe Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2020 të datës 03.12.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë konstatoi se ankesa e ankuesit . , është e pa bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e Mbikëqyrësit në Qendrën e Paraburgimit në Pejë - Shërbimi Korrektues i Kosovës, dhe si rrjedhojë i njëjti mban statusin e nëpunësit civil.

Zëvendësdrejtori i Qendrës së Paraburgimit në Pejë, njëherit mbikëqyrës i drejtpërdrejt i ankuesit, me datë 04.11.2022 ka iniciuar procedure disiplinore ndaj ankuesit për shkak të shkeljes së pretenduar disiplinore nga neni 58 paragrafi 3.6 dhe neni 64 të Ligjit Nr.08/L-131 Për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ngase i njëjti me datë 03.11.2022 kishte shpërndarë shkresa zyrtare në rrjete sociale (facebook).

Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 21.11.2022 ka nxjerr Vendimin me numër KD.nr.048/2022 të datës 23.11.2022 me të cilin ka shpallur ankuesin përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me arsyetimin se i njëjti pa ndonjë autorizim nga organi përkatës i punësimit ka publikuar në rrjete sociale-facebook të dhëna mbi proceset e rekrutimit me pretendime për keqpërdorime dhe duke parafrazuar zyrtar dhe ish zyrtarë të lartë të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe ndaj të njëjtit Komisioni Disiplinor ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim 20% e pagës për periudhën dy (2) muaj" nga neni 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton Vendimin me numër KD.nr.048/2022 të datës 23.11.2022 të Komisionit Disiplinor, me pretendimin ankimor se me datë 03.11.2022 ka shpërfaq një mori parregullsish që e preokupojnë Qendrën e Paraburgimit në Pejë, duke theksuar se ketë e ka bërë duke u bazuar në liri të shprehjes dhe duke filluar nga ajo se këto publikime nuk bien ndesh me rendin dhe ligjin





sepse nuk janë dokumente konfidenciale që rrezikojnë sigurinë e burgjeve, nuk janë kërcënime apo shantazhe ndaj askujt, por thjesht si pikë synimi kanë ndaljen e nepotizmit dhe korrupsionit që fatkeqësisht kanë kapluar Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë, dhe paragrafit 4 ku përcaktohet se: 4. Rregullimi me akt të veçantë, sipas paragrafit 4 të këtij neni, bëhet për: 4.4 Të drejtat dhe detyrimet specifike tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj, dhe si rrjedhojë duke u bazuar në dispozitat e ligjit të veçantë, në ketë rast dispozitat e nenit 58 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstatoi se personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës e kanë të ndaluar dhënien e deklaratave publike pa autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm.*

Andaj, duke marr parasysh faktin se ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill nuk e konteston postimin e bërë në rrjete sociale - facebook me datë 03.11.2022 lidhur me pretendimet e tij për keqpërdorime, nepotizëm dhe korrupsion në Shërbimin Korrektues të Kosovës, duke përfshi këtu edhe shpërndarjen e shkresave zyrtare, çështje këto të cilat sipas aktit të kontestuar ankuesi i konfirmon edhe në seancën e organit të shkalles së parë, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit në kuptim të shkeljes se detyrimeve ligjore ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe po ashtu drejtë ka zbatuar ligjin material, ngase edhe në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit ankuesi me veprimin e tij ka rënë ndeshë me detyrimet e zyrtarit publikë të përcaktuara me nenin 25 paragrafi 3, nenin 28 dhe nenin 30 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke konsumuar kështu elementet e shkeljes disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin 58 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se veprimet e keqpërdorimit, nepotizmit dhe korrupsionit brenda një organi të punësimit mund të sinjalizohen nga çdo i punësuar, mirëpo sinjalizimi dhe raportimi duhet të behet përmes ndjekës se procedurave dhe rrjedhimisht respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi dhe jo përmes deklaratave publike të paautorizuara, ngase me veprime të tilla cenohet imazhi dhe integriteti i nëpunësve civil dhe institucionit përkatës të punësimit.

Rrjedhimisht, meqenëse ankuesi nga shkresat e administruara të lëndës nuk ka arritur të vërtetojë faktin se në rrethanat e rastit konkret janë ndjekur procedurat e raportimit të shkeljeve të pretenduara, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore, ngase ankuesi në cilësinë e zyrtarit publikë gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim dhe po ashtu organi i shkalles së parë drejt ka zbatuar ligjin material me rastin e përcaktimit të masës disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, duke vepruar në pajtim me nenin 50 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.





Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËSYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr.1087/2022.**

Zylë Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.